


VLERËSIMI AGROMETEOROLOGJIK PËR PERIUDHËN 21-30.09.2004

Gjatë kësaj periudhe pritet që territori i vendit të karakterizohet nga tiparet kryesore të stinës së vjeshtës, pra; me një ulje të temperaturave, me vranësira në rritje dhe rreshje të cilat përpara fermereve dhe të gjithë të interesuarve për situatën e pritëshme agrometeorologjike, do të duhej të nënvizonim sa vijon si më të rëndësishme: - së pari, në tërësi duhet përqëndruar vëmendja në punimet me tokën dhe përgatitjen e parcelave për mbjelljet e vjeshtës, në mënyrë që ato të realizohen në kushte sa më optimale përsa i përket lagështisë dhe temperaturës së tokës; - në serra, në kulturat e dyta të përqëndrohet vëmendja në kontrollin nga sëmundjet e dëmtuesit si hiri, vrugu, etj., dhe të fillojë trajtimi kur ndjehet i nevojshëm; - në ullinj meqënëse kokrrat po arrijnë në madhësinë maksimale dhe kushtet e pritëshme agrometeorologjike krijojnë premisa për prekje nga miza e ullirit duhet të intensifikohet e shtohet vëmendja ndaj mizës së ullirit; - në agrume duhet të intensifikohen vërtjetet për prekjen nga tenja, ndërkohë që një vëmendje e veçantë duhet treguar ndaj fidanëve të rinj.



BIOMETEOROLOGJI: Vlerësimi i treguesit të rrezatimit UV për periudhën 21-25.09.2004 në rajonin ku ndodhet dhe vendi ynë, jepet nëpërmjet treguesve simbolike, paraqitur në tabelën në vijim. Mbi vlerën 3 ky rrezatim paraqitet i rrezikshëm, sidomos në orët e mesditës.

Data:	21 shtator	22 shtator	23 shtator	24 shtator	25 shtator
Treguesi i Rrezatimit Ultraviolet					

i Për informacione më të fundit në lidhje me vlerësimin agrometeorologjik të situatës jeni të mirëpritur të na kontaktoni në adresën: Instituti Hidrometeorologjik Rruga e Durrësit, Tiranë; ose Kutisë Postare Nr. 219; si dhe nëpërmjet numrave: Tel & Fax: 04 223 518 Drejtoria; Tel: 04 259359/53 Sektori i Agrometeorologjisë & E-mail: agrometeoalb@yahoo.com



Në foto : Instituti Hidrometeorologjik, Tiranë.

Përgatitur nga Sektori i Agrometeorologjisë

Botim i Akademisë së Shkencave - Instituti Hidrometeorologjik

Tiranë, © 2004.

Abonimi vjetor: 3600 Lekë

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose transmetohet pa lejen me shkrim të botuesit.



AKADEMIA E SHKENCAVE INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK Departamenti i Meteorologjisë Sektori i Agrometeorologjisë

Adresa: Rr. Durrësit, K.P.219, Tiranë.

Tel:(+ + 355)4 259359/53 Fax:(+ + 355)4 223518

E-mail: agrometeoalb@yahoo.com

B U L E T I N I AGROMETEOROLOGJIK

Nr. 26

Muaji: SHTATOR

Dekada: e dytë




TIRANË, 2004

Vlerat Mesatare të Treguesve Agrometeorologjike për periudhën: 11-20 shtator 2004

Vëndmatjet	TREGUESIT AGROMETEOROLOGJIK							
	T. max abs.	T. min abs.	T. mes (°C)	$\Sigma TA > 10^{\circ}C$	Σ Reshje mm	Nr.ditë Reshje >0mm	Avullimi ditor ne mm	Ndryshimi temp. me dek.I-09
Koplik	30.4	11.6	21.9	219.1	1.5	1	3.9	-1.9
Shkodër	30.6	15.1	22.1	221.4	1.5	1	4.0	-2.3
Lezhë	28.7	10.6	21.0	210.0	3.1	1	3.8	-2.2
Durrës	28.2	13.8	21.7	216.6	3.0	1	3.9	-1.8
Tiranë	29.7	12.7	22.1	221.1	3.5	1	4.0	-1.1
Elbasan	33.0	11.5	22.9	229.4	3.5	1	4.1	-2.1
Cërrik	32.4	10.5	22.3	223.1	4.0	1	4.0	-0.9
Vlorë	29.0	11.7	20.8	207.9	0.0	0	3.7	-0.5
Kukës	32.4	1.6	17.4	173.7	7.4	1	3.1	-1.4
Peshkopi	28.0	4.0	17.2	172.0	17.0	3	3.1	0.2
Pukë	26.5	8.0	17.4	174.4	4.2	1	3.1	-1.5
Bulqizë	26.5	6.0	16.5	165.0	20.2	2	3.0	-1.3
Pogradec	27.5	5.0	16.4	163.8	15.5	2	2.9	-0.9
Korçë	28.0	6.0	16.2	162.2	1.0	1	2.9	-1.3
Ersekë	27.0	4.0	16.2	161.5	41.8	3	2.9	0.6

Situata Agrometeorologjike për periudhën 11-20.09.2004

Kjo periudhë u karakterizua me një tendencë të lehtë në rritjen e temperaturave të ajrit, që gjithëse si si mesatare ishin më të ulta me 1-2°C se dekada e mëparshme. Rreshje të pakta me lartësi përgjithësisht nën normë, u vrojtuan në datat 17-18 shtator. Temperatura minimale më e ulët 1.6°C u shënua në Kukës dhe temperatura maksimale më e lartë 33.0°C u shënua në Elbasan. Gjatë kësaj periudhe u grumbullua një $\Sigma TA > 10^{\circ}C$ nga 160 deri 230°C. Avullimi ditor në nivele 3-4mm.




FENOLOGJIA: Në kulturën e misrit, në vartësi të varietetit, zonës agroklimatike dhe datës së mbjelljes, vijon korrija, ndërsa në zonat e larta vijon pjekja e dyllit. Në pemë frutore e vreshta vijon rritja e frutave, pjekja, ndërsa në disa prej tyre ka përfunduar vjelja dhe ndodhen në qetësi biologjike, zverdhje e rënie gjethesh. Në ulli vazhdon rritja e frutit dhe ka filluar grumbullimi.

* * *

Vlerat Mes. Shumëvjeçare të Treguesve Agroklimatike për periudhën: 21-30 shtator

Vëndmatjet	TREGUESIT AGROKLIMATIKE	
	T. mes. e ajrit në (°C)	Rreshjet në (mm)
Koplik	19.6	54.0
Shkodër	19.2	97.5
Lezhë	19.8	35.5
Durrës	20.0	25.1
Tiranë	19.4	28.5
Elbasan	19.3	23.6
Cërrik	19.7	24.3
Vlorë	20.6	21.9
Kukës	16.2	30.3
Peshkopi	16.1	22.0
Pukë	14.7	63.3
Bulqizë	14.3	25.0
Pogradec	16.0	13.6
Korçë	15.1	14.9
Ersekë	14.1	17.4
Himarë	21.0	42.5
Lushnjë	20.4	18.6
Fier	19.1	18.1
Berat	19.3	19.1

Luhatjet e temperaturës ndaj normës paraqiten në grafikun në të majtë. Në vlerat e amplitudave të temp. së ajrit vërehet një rritje e tyre sidomos në pjesën VL & JL të vëndit kundrejt dekadës së mëparshme. Shpërndarja territoriale jepet në grafikun në vijim.



Parashikimi i motit për periudhën: 21-30.09.2004

Ky 10-ditor, fillon të rishfaqë mundësi për rreshje të izoluara shiu në veri të vëndit që në datë 22 (kryesisht, në zonat malore). Por, situata do të bëhet mjaft e paqëndrueshme në datat 25-28 për shkak të një qarkullimi ciklonar që fillon të bëhet mbizotërues. Pikërisht, në këto data priten rreshje në të gjithë territorin. Më pas situata rifillon të stabilizohet. Temperaturat: mesatarja e periudhës pritet të jetë rreth normës shumëvjeçare.

Sektori i Parashikimeve Meteorologjike Tel: 222439

